VENDIM
Nr.536, datë 21.12.1992

PËR ZBATIMIN E DETYRAVE NGA MINISTRITË PËR EMBARGON NDAJ SERBISË DHE MALIT TË ZI

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Ekonomisë dhe e Financave të marrin të gjitha masat për të ndaluar daljen nga pikat tona të kalimit kufitar të naftës e nënprodukteve të saj, të energjisë elektrike, të qymyrgurit, pajisjeve elektrike, hekurit, çelikut, gomave të automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve të destinuara për në Serbi ose Mal të Zi.

Gjithashtu këto dy ministri dhe ministritë e tjera duhet t'i ndërpresin importet e të gjitha llojeve të mallrave që janë prodhuar në Serbi ose Mal të Zi.

2. Ministria e Ekonomisë dhe e Financave të marrin masat për ndalimin e transferimit të fondeve për qëllime tregtare në Serbi e Mal të Zi.

3. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve të organizojnë punën për ndalimin e kalimit, të qëndrimit ose të nisjes nga territori i Republikës së Shqipërisë të anijeve dhe avionëve, të cilët kanë si vendmbërritje përfundimtare Serbinë ose Malin e Zi.

4. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore që kanë pësuar ose pësojnë dëme nga zbatimi i embargos, t'i llogaritin ato dhe t'ia paraqitin Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi